



Gjuha e fëmijës nga mosha afër 6 muaj

Disa gjëra të vogla për gjuhën e fëmijës tënd nga mosha 6 muaj

- Fëmija yt ka shumë për të zbuluar në botë! Shiko se çfarë po shikon fëmija dhe përdor fjalën përkatëse për ato gjëra. Së bashku mund të zbuloni gjithë ato gjëra interesante, si të vogla ashtu edhe të mëdha!
- Që tani fëmija yt bisedon me ty duke përdorur mimikë, tinguj dhe lëvizje. Së shpejti fëmija yt do të fillojë të belbëzojë me tinguj që ngjajnë me fjalë.
- Fëmija yt fillon së shpejti të kuptojë shprehje si shiko apo fjalë si mami dhe babi.
- Fëmija yt ka dëshirë të madhe të bisedojë me ty, të lozi dhe të përcjell lojëra të thjeshta me lëvizje dhe ninulla.

Bashkëbisedo për çdo gjë

Fol për çdo gjë që ndodh dhe që tërheq interesimin e fëmijës tënd. Fol për ushqim, për rroba, për atë çfarë ju shihni dhe për atë çfarë fëmija është duke bërë. Dëgjoje fëmijën me gjallëri në mënyrë që fëmija të ketë dëshirë për të vazhduar bisedën. Jepi fëmijës dhe bisedës kohën e duhur!

Ndrysho dhe përsërit

Përsërit tingujt që lëshon fëmija, mundohu ta gesh domethënien dhe t'i vësh fjalë asaj që fëmija mundohet të shprehë. Prit derisa fëmija reagon me tingujt ose lëvizje para se të vazhdosh. Fëmija që tani mëson të shkëmbejë rolet folës-dëgjues gjatë bisedimit dhe të kuptojë lidhjen mes fjalëve dhe gjësëndeve

Lozje me gjuhën

Këndo këngë, vargje dhe ninulla dhe luaj lojëra këndimi. Përdor gishtat, pipëzimet, ulërimat dhe bëjë shaka! Në bibliotekën tënde ka libra, këngë dhe muzikë të cilat mund t'i huazosh në shtëpi.

Flisni dhe lexoni së bashku

Kur fëmija mund të ndjek shikimin tënd dhe drejtimin e gishtit tregues atëherë libri me ilustrime bëhet një i njohur joshës. Bëj me shenjë nga ilustrimet dhe trego për to. Ji i vëmendshëm në ato gjëra për të cilat fëmija yt tregon interesim. Në fillim interesimi i fëmijës është kohëshkurtër por së shpejti rritet aftësia e fëmijës për tu fokusuar.


Fol gjuhën tënde amtare

Fol, këndo dhe lexo në gjuhën tënde amtare. Shumica e fëmijëve në botë jetojnë në mjedis shumëgjuhësor, dhe është vetëm përparësi të rritesh në mjedis me më shumë se një gjuhë.

Zbulo më shumë

- Për Bokstart mund të lexosh më shumë në: www.bokstart.se
- Nëse je i shqetësuar për zhvillimin e gjuhës së fëmijës tënd, drejtohu në qendrën shëndetësore për fëmijë. Gjithashtu mund të diskutosh zhvillimin e gjuhës së fëmijës tënd me personelin e parashkollores.

Këshilli i Kulturës ka detyrë nga qeveria për të mbështetur dhe nxitur leximin dhe për të stimuluar zhvillimin gjuhësor të fëmijëve të vegjël. Bokstart është një nismë mbarkombëtare që u drejtohet prindërve dhe të rriturve që janë afër fëmijëve.



Gjuha e fëmijës nga mosha afër 1 vjet

Disa gjëra të vogla për gjuhën e fëmijës tënd nga mosha 1 vjet

- Fëmija do përdor gjeste dhe tinguj për të treguar ty diçka.
- Fjalët e para kanë të bëjnë me gjëra të tanishme në mjedisin ekzistues siç janë për shembull fjalët top, plush dhe shiko.
- Fëmija yt kupton shumë më shumë fjalë nga sa mund të shprehë por ka nevojë për ndihmën tënde për të sqaruar dhe komentuar fjalët.

Ndiq interesimet e fëmijës tënd

Ti mund të përdorësh çdo gjë që shihni dhe bëni gjatë jetës së përditshme për të zhvilluar gjuhën e fëmijës. Emëro gjërat që fëmija ka në vëmendje në kohë reale. Kur fëmija thotë atje, dhe bën me shenjë drejt një mace, ti mund të përgjigjesh: Po, kjo është një mace. A të pëlqen macja? Mos harro të presësh derisa fëmija të kthejë përgjigjen.

Ji i vëmendshëm dhe dëgjo

Kur ti i jep fëmijës vëmendje të pandashme dhe e dëgjon me kujdes, atëherë fëmija do të ndiejë se ti mendon se mesazhi është i rëndësishëm, andaj fëmija ose do thotë një fjalë, do bëjë një gjest me shenjë apo në ndonjë mënyrë tjetër do të komunikon ty diçka tjetër. Nga përgjigjet tua, fëmija mëson se ju do të ndërroni rolet kur bisedoni, një herë je dëgjues e një herë folës.

Bëj lojëra me gjuhën

Këndo këngë, vjersha dhe vargje lojërash dhe luaj lojëra këndimi. Përdor gishtat, pipëzimat, ulërimat dhe bëjë shaka!

Këshilli i Kulturës ka detyrë nga qeveria për të mbështetur dhe nxitur leximin dhe për të stimuluar zhvillimin gjuhësor të fëmijëve të vegjël. Bokstart është një nismë mbarkombëtare që u drejtohet prindërve dhe rriturve që janë afër fëmijëve.

Krijo histori të shkurtra dhe trego

Trego histori të shkurtra, për shembull histori për të bërë aty përjashta. Flisni për fotografitë e farefisit dhe të miqve. Fëmija ka nevojë të dëgjojë fjalë të reja të përsëritura shumë herë dhe në rrethana të ndryshme.

Lexo libra të thjeshtë me ilustrime

Tani ju mund të filloni të lexoni së bashku libra me ilustrime të thjeshta. Në fillim ju shikoni ilustrimet dhe bëni me shenjë me gisht së bashku. Në fillim është më lehtë kur ti të tregosh vetë, mirëpo së shpejti fëmija arrin të dëgjojë tekstin e librit. Në bibliotekën tënde do të gesh udhëzime për librat që mund t'i huazosh në shtëpi.


Fol gjuhën tënde amtare

Fol, këndo dhe lexo në gjuhën tënde amtare! Shumica e fëmijëve në botë jetojnë në mjedis shumëgjuhësor, dhe është vetëm përparësi të rritesh në mjedis me më shumë se një gjuhë.

Zbulo më shumë

- Për Bokstart mund të lexosh më shumë në: www.bokstart.se
- Nëse je i shqetësuar për zhvillimin e gjuhës së fëmijës tënd, drejtohu në qendrën shëndetësore për fëmijë. Gjithashtu mund të diskutosh zhvillimin e gjuhës së fëmijës tënd me personelin e parashkollës.

Bokstart



Gjuha e fëmijës nga mosha afër 18 muaj

Disa gjëra të vogla për gjuhën e fëmijës tënd nga mosha 18 muaj

- Shumë fëmijë të kësaj moshe kuptojnë afërsisht 200 fjalë të përditshme.
- Fëmija përdor vetë një pjesë të mirë të fjalëve, por fjalët mund të kenë domethënie të ndryshme në rrethana të ndryshme.
- Disa fëmijë fillojnë të lidhin bashkë fjalët, si për shembull Nënë, makinë, baba, atje.

Bisedoni shumë me njëri-tjetrin

Flisni për atë që bëni në situata të ndryshme. Tregoj fëmijës se çfarë është duke ndodhur dhe emëroni gjërat që jeni duke bërë. Dëgjo me kujdes se çfarë po dëshiron dhe po mendon fëmija. Kush-toj fëmijës tënd kohë të mjaftueshëm.

Poho dhe zhvillo tutje atë çfarë thotë fëmija

Kur ti përdor fjalët e vetë fëmijës dhe shton fjalë të reja, ti i ndihmon fëmijës të zhvilloj gjuhën e vetë. Fëmija shpesh përdor fjalë të vetat. Mos e korrigjo fëmijën por përdore vetë fjalën e drejtë në mënyrë që fëmija ta dëgjoj se si duhet të tingëllojë fjala përkatëse.

Ndërlidhu me botën e fëmijës

Është më e lehtë për fëmijën të mësojë gjëra të reja nëse ti i ndërlidh këto gjëra me diçka që fëmija tanimë e njeh. Nëse shikon një fotografi të

pantallonave, atëherë mund të bësh me gisht nga pantallonat e vetë fëmijës dhe të thuash: Edhe ti ke pantallona, ashtu si ai fëmija në libër.

Flisni dhe lexoni së bashku

Fëmija tani ka dobi nga shumë librat e ndryshëm për të cilët ju mund të bisedon së bashku. Bëj pyetje të hapura rreth gjërave që ndodhin në libra dhe bëj ndërlidhje me përvojën e fëmijës: Çfarë mendon ...? A të kujtohet...?


Fol gjuhën tënde amtare

Fol, këndo dhe lexo në gjuhën tënde amtare! Shumica e fëmijëve në botë jetojnë në mjedis shumëgjuhësor, dhe është vetëm përparësi të rritesh në mjedis me më shumë se një gjuhë.

Zbulo më shumë

- Për Bokstart mund të lexosh më shumë në: www.bokstart.se
- Nëse je i shqetësuar për zhvillimin e gjuhës së fëmijës tënd, drejtohu në qendrën shëndetësore për fëmijë. Gjithashtu mund të diskutosh zhvillimin e gjuhës së fëmijës tënd me personelin e parashkollës.

Këshilli i Kulturës ka detyrë nga qeveria për të mbështetur dhe nxitur leximin dhe për të stimuluar zhvillimin gjuhësor të fëmijëve të vegjël. Bokstart është një nismë mbarkombëtare që u drejtohet prindërve dhe të rriturve që janë afër fëmijëve.



Gjuha e fëmijës nga mosha afër 3 vjet

Disa gjëra të vogla për gjuhën e fëmijës tënd nga mosha 3 vjet

- Shumë fëmijë të kësaj moshe tani i kuptojnë disa qindra fjalë. Fëmija mund të lidhë së bashku radhë të fjalëve në fjali dhe të zhvillojë biseda të shkurtra.
- Fëmija bën pyetje të shumta dhe fillon të kuptojë si të përdorë fjalët dhe si të luaj me këto fjalë.
- Fëmija yt fillon të flas për gjëra që ka përjetuar dhe ka dëshirë të dëgjojë kur ti tregon gjëra.

Zbulo shkronja dhe fjalë

Në moshën parashkollore shumë fëmijë janë kureshtar të njohin shkronjat dhe fjalët. Lexo dhe bëj me she-një në tabela dhe pako kur e sheh që fëmija yt tregon interesim për to. Zbuloni së bashku shenja dhe simbole rreth e rrotull dhe flisni për domethënien e tyre.

Shpjego fjalë të reja

Përdor fjalë të reja për ngjarjet që ndodhin, dhe për gjërat që shihni, në jetën e përditshme. Shpjego fjalët që fëmija nuk i kupton: shpjego për shembull se deti është një lloj i liqenit, por shumë më i madh se liqeni. Ose: shpjego se kur të shkojmë poshtë në plazh, do të lahemi në det.

Bashkëbisedo

Fol për gjëra që kanë ndodhur gjatë ditës. Përpiqu të ndjekësh diçka që ke dëgjuar apo par se fëmija ka bërë në parashkollore dhe ftoje fëmijën të tregojë më shumë për këtë gjë. Shumica e trevjeçarëve nuk i shqiptojnë fjalët ashtu siç i shqiptojmë ne të rriturit. Kur dëgjon një fjalë që tingëllon ndryshe atëherë thuaje fjalën ashtu si duhet thënë dhe fëmija brenda një kohe të shkurtër do ta shqiptojë fjalën drejtë ashtu si duhet.

Lexoni së bashku

Bëje për shprehi leximin për një kohë të shkurtër për çdo ditë. Shumë fëmijë kanë një libër të preferuar që ata duan t'ua lexosh shumë e shumë herë.

Librat me ilustrime tani mund të përmbajnë histori pak më të komplikuar, por ende vlen të përdoret bashkëveprimi bisedë-lexim.

Nxit fëmijën të bisedojë mbi përmbajtjen e librit dhe jepi fëmijës cytje të bëjë pyetje në ndërkohë. Kur fëmija bën pyetje, atëherë ndalo dhe përgjigju në pyetje.

Mos harro se loja është mënyra e fëmijës për të mësuar. Andaj luani, lexoni, këndonin dhe tregoni së bashku. Rimat, ninullat dhe këngët janë ende mjaftë argëtuese. Leximi i librave është mënyra më e mirë për të mësuar fjalë të reja!

Fol gjuhën tënde amtare

Fol, këndo dhe lexo në gjuhën tënde amtare! Shumica e fëmijëve në botë jetojnë në mjedis shumëgjuhësor, dhe është vetëm përparësi të rritesh në mjedis me më shumë se një gjuhë.

Zbulo më shumë

- Për Bokstart mund të lexosh më shumë në: www.bokstart.se
- Nëse je i shqetësuar për zhvillimin e gjuhës së fëmijës tënd, drejtohu në qendrën shëndetësore për fëmijë. Gjithashtu mund të diskutosh zhvillimin e gjuhës së fëmijës tënd me personelin e parashkollës.

Këshilli i Kulturës ka detyrë nga qeveria për të mbështetur dhe nxitur leximin dhe për të stimuluar zhvillimin gjuhësor të fëmijëve të vegjël. Bokstart është një nismë mbarkombëtare që u drejtohet prindërve dhe t rriturve që janë afër fëmijëve.